



**Aplikim për vizë me qëllim pjesëmarrjen në një kurs gjuhe**  
(edhe për kurse gjuhe përgatitore për studime)

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit, si dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Në varësi të zyrës së të huajve procedurat mund të zgjasin deri në 3 muaj. Ndaj aplikoni për vizë në kohën e duhur. Lutemi për mirëkuptimin Tuaj që brenda 12 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

**Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:**

1.	<b>Formularë aplikimi</b>	Në gjermanisht ose anglisht, <b>në dy kopje</b> , të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht.
2.	<b>Tarifa</b>	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhet <b>kesh në monedhën shqiptare LEK</b> . Tarifa është 75 Euro përllëgëritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	<b>Fotografi pashaporte</b>	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.
<b>Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, me 2 fotokopje, në momentin e aplikimit</b>		
4.	<b>Pashaporta</b>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
5.	<b>Regjistrimi në kursin e gjuhës</b>	Dëshmi e regjistrimit në një kurs intensiv gjuhe me mini malishtë 18 orë mësimi në javë dhe konfirmimi i pagesës së tarifës së kursit. Shënim: Duke qenë se shtetasit shqiptarë kanë të drejtën e qëndrimit pa vizë për një periudhë deri 90-ditore në vendet e Schengen-it, do të përpunohen vetëm ato aplikime për kurse gjuhe me kohëzgjatje më të madhe se atë.
6.	<b>Dëshmi e gjuhës</b>	Dëshmi për përvetësimin e njohurive ekzistuese të gjuhës gjermane, në varësi të nivelit të gjuhës së kursit të rezervuar

	<b>gjermane/angl eze</b>	<i>Kujdes: Lutemi të mbani në konsideratë që mund të pranohen vetëm çertifikata nga institute gjuhësore të njohura ndërkombëtarisht (Instituti Goethe, ÖSD, telc)!</i>
7.	<b>Dëftesa e maturës resp. Dëshmi për diplomën më të lartë arsimore (Bachelor / master/ Pfd)</b>	Vërtetimi të drejtës për të vazhduar studimet e larta (diplomë, librezë studenti ose vërtetim i përfundimit të shkollës) në fotokopje të noterizuar, <b>të përkthyer dhe me vulë apostile</b>
8.	<b>Dëshmi e financimit</b>	Vërtetim për mundësi financimi prej të paktën 720 euro në muaj për një vit depozituar paraprakisht. Mundësitë janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- hapja e një llogarie bankare të bllokuar (Sperrkonto)</li> <li>- Përmes një burse – njoftimi i dhënies së bursës duhet të jetë në origjinal Ose</li> <li>- Një deklaratë garancie sipas §§66-68 të Ligjit për të Huajt, në të cilën një person i tretë merr përsipër me shkrim kostot përkatëse (pranë Zyrave të të Huajve në Gjermani mund të gjenden formularët e deklaratave të tilla të garancisë).</li> </ul>
9.	<b>Siguracion i mjaftueshëm shëndeti</b>	Për gjithë kohëqëndrimin në Gjermani nevojitet të paraqitet një siguracion shëndetësor që mbulon një shumë prej min. 30.000 eurosh. Rekomandohet lidhja e një siguracioni shëndetësor për studentë për të gjithë kohëzgjatjen e qëndrimit, ose sigurimi pranë një agjencie gjermane siguracionesh shëndetësore - dëshmia përkatëse do të duhet të paraqitet pranë zyrës së të huajve pas hyrjes në Gjermani.
10.	<b>Shkresë motivimi e nënshkruar nga aplikanti</b>	Përshkruani ju lutem konkretisht, pse dëshironi të frekuentoni këtë kurs gjuhe në Gjermani, si e keni përzgjedhur shkollën dhe çfarë dëshironi të bëni pas përfundimit të kursit? Në rastin e kurseve përgatitore të studimeve duhet të informoni rreth aplikimeve pranë universiteteve, uni-assist apo planeve tuaja konkrete.
11.	<b>Jetëshkrim</b>	Lutemi, informoni se si ka qenë vijimësia juaj shkollore dhe profesionale
12.	<b>Minorenët</b>	Në rastin e minorenëve nevojitet edhe certifikata e tyre e lindjes (çertifikatë në shqip me vulën apostile dhe përkthimin në gjuhën gjermane) dhe një deklaratë e noterizuar e dakordësisë së prindërve/kujdestarit ligjor për largimin e fëmijës me qëllim studimesh

Si dëshmi në mbështetje të pjesëmarrjes në një kurs gjuhe në Gjermani rekomandohet që gjatë aplikimit të provohet në mënyrë të besueshme niveli A2 i zotërimit të gjuhës gjermane (përmes certifikatave të gjuhës, vërtetimeve të pjesëmarrjes etj.).

Gjatë procedurave të aplikimit Ambasada mund të kërkojë në raste të veçanta dokumenta të tjera shtesë, që nuk përmenden në këtë fletë informacioni.

#### **Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:**

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.